



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2019:114687  
Datë: 23.02.2024  
Numri i dokumentit: 05365160

KE.nr.2570/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit Ringov i Ri – H.K. Sh.P.K., me nr. unik identifikues 810483397 dhe me seli në Pejë, rr. “Nexhmedin Elshani” p.n., që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat S.B. nga Peja, kundër të paditurve 1. NNP “TOSI” me nr. unik identifikues 810407321 dhe seli në Pejë, rr. “ F.Agani”, nr. 22, me pronar Q si dhe 2. F.U. nga Peja, me objekt kontesti pagesë e borxhit, në seancën përgatitore të datës 23.02.2024 morri këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit “Ringovi i Ri” Sh.P.K., kundër të paditurve 1. NNP “TOSI” me seli në Pejë me pronar F.U. si dhe 2. F.U., me objekt kontesti kthim i borxhit, lënda e identifikuar pranë kësaj gjykate me shenjën KE.nr. 2570/22 (Lidhja C.nr. 1335/17).
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

**A r s y e t i m**

Paditësi Ringov i Ri – H.K. Sh.P.K., me datë 20.12.2017 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Pejë, kundër të paditurve 1. NNP “TOSI” me seli në Pejë me pronar F.U. si dhe 2. F.U., me objekt kontesti kthim i borxhit.

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr. 1335/17 të datës 29.06.2021 ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 732/2022

të datës 06.10.2022, ka aprovuar ankesën e paditësit ashtu që ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr. 1335/17 të datës 29.06.2021, dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

Gjykata, në rivendosje, ka caktuar dhe mbajtur seancë përgatitore lidhur me këtë çështje juridike me datë 23.02.2024.

Në seancën përgatitore, nuk ka prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit edhe pse i njëjti ka qenë të ftuar në mënyrë të rregullt për këtë seancë, fakt këtë të cilin gjykata e konstatoi nga flete kthesa e Postes se Kosovës pjese e shkresave te lendes, nga e cila rezulton se përfaqësuesi i paditësit avokat S.B. e ka pranuar ftesën për seancë me date 25.01.2024, mirëpo në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

Në seancë nuk kanë prezantuar as palët e paditura, edhe pse të njëjtit po ashtu kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, fakt këtë të cilin gjykata e konstatoi nga fletë kthesa e Postes se Kosovës pjesë e shkresave të lendes, nga e cila rezulton se të njëjtit ftesën për seancë e kanë pranuar me datë 30.01.2024, mirëpo në seancë nuk kanë prezantuar dhe mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 409 paragrafin 1 të LPK-së, më të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit “Ringovi i Ri” Sh.P.K., kundër te paditurve 1. NNP “TOSI” me seli në Pejë me pronar F.U. si dhe 2. F.U..

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 409 par.1 dhe 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2570/22, datë 23.02.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.